



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. M., për shkak të veprës penale *“Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge”*, nga neni 267, paragrafi 1., lidhur me nenin 275, paragrafin 1., nën-paragrafi 1.9., lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPRKR.nr.319/23, të datës 09.01.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.DKR.nr.74/2024 të datës 23.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit A. M., ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPRKR.nr.319/23, të datës 09.01.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.DKR.nr.74/2024 të datës 23.01.2024, ashtu që të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti do të lirohet menjëherë sot me datën 12.02.2024, për tu mbrojtur në liri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.319/23, të datës 09.01.2024, të pandehurit A. M., për shkak të veprës penale *“Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge”*, nga neni 267, paragrafi 1., lidhur me nenin 275, paragrafin 1., nën-paragrafi 1.9., lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi do t’iu llogaritet nga data 12.01.2024 e deri me datën 12.03.2024. Të pandehurit paraburgimi iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1., e 1.2., pika 1.2.1., 1.2.2. dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PN1.DKR.nr.74/2024 të datës 23.01.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesë e mbrojtësit të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësit i të pandehurit A. M., avokat Halit Shaljani, për shkak të shkeljes së ligjit penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që kjo kërkesë të aprovohet si e bazuar dhe aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.III.nr.36/24 e datës 08.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit, vlerësoj se aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe i pandehuri duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se këto aktvendime janë të paqëndrueshme, për çka me të drejtë tërheq vërejtjen mbrojtësi në kërkesën e tij.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, së pari si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë me rastin e vazhdimin të paraburgimit nuk kanë dhënë arsye konkrete dhe të pranueshme sa i përket bazave ligjore për vazhdimin e paraburgimit, nëse duhet t'i vazhdohet masa e paraburgimit, për faktin se arsyet që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë, e që pothuajse i ka përshkruar edhe gjykata e shkallës së dytë, nuk kanë qenë konkret të argumentuara.

Gjykata kur cakton/vazhdon ndonjëherë nga masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit në proces gjyqësorë, duhet të japë arsye të qarta për secilën bazë ligjore, e jo të mjaftohet me parafrazimin e dispozitës ligjore. Në rastin konkret gjykatat e niveleve më të ulëta, përpos një parafrazimi të ligjit, nuk kanë bërë asnjë përpjekje për të dhënë arsye për bazat ligjore të paraburgimit dhe nga shkresat e lëndës, nuk rezulton se në rastin konkret është përmbushur ndonjëherë nga bazat ligjore për vazhdimin e paraburgimit në të cilat janë thirrë gjykatat e instancave më të ulëta.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk qëndron fakti se i pandehuri do të mund të ikë - arratiset dhe të pengojë rrjedhën normale të procedurës penale, ngase të njëjtit i dihet identiteti, vendbanimi si dhe është shtetas i Republikës së Kosovës, e

gjithashtu nuk qëndron as fakti se i njëjti mund të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në bashkëkryerësit tjerë të cilët gjenden në arrati, ngase nuk ka asnjë indikacion se ai do të mund të ndikojë tek ata, apo se mund të përsëris veprën penale, ngase në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë provë bindëse që do të mund vërtetonte një fakt të tillë. Pra, nga e gjithë kjo del se në rastin konkret, nuk rezulton e bazuar frika për mundësinë e arratisjes, ndikimit apo përsëritjes së veprës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes posaçërisht ka pasur parasysh dhe ka aplikuar nenin 185, paragrafi 3. të KPP-së se: *“Paraburgimi hiqet dhe i paraburgosuri lirohet në çdo fazë të procedurës posa të pushojnë shkaqet e caktimit të tij”*, që nga interpretimi logjik i kësaj dispozite mund të konkludohet se paraburgimi paraqet masën e fundit *“ultima ratio”* dhe e cila duhet të aplikohet vetëm përjashtimisht dhe nën kushte të përcaktuara dhe gjithmonë gjykata duhet të mbajë parasysh se: *“prezumimi është në favor të lirit”* nga paraburgimi në raport me qëndrimin e tij në paraburgim.

Për arsyet e lartcekura, e në bazë të nenit 438, paragrafi 1., nën paragrafi 1.1. të KPP-së, aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.90/2024, më datën 12.02.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit,
Agim Maliqi